

VENDIM

PANELI NR. 1

VENDIMI NR.: KPCC/D/A/30/2008

DATA E VENDIMIT 19/12/2008

URDHËR

Në kërkesat nr. 07940, 39711, 39717, 39718, 39720, 39721, 39722, 39723, 39728, 39730, 39731 dhe 51032 Komisioni vendos që kërkesat të refuzohen.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ("Kuvendi") ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-079 duke përshtatur dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 ("UNMIK/REG/2006/50") mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") duke përshtatur dhe ndryshuar Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2007/5 ("UNMIK/ADM/DIR/2007/5"), e cila zbaton UNMIK/REG/2006/50. Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi I ka themeluar Agjencinë Kosovare të Pronës ("KPA") si agjenci të pavarur sipas Nenit 142 të Kushtetutës së Kosovës, dhe ka ndryshuar dispozitat përkatëse të UNMIK/REG/2006/50 dhe UNMIK/ADM/DIR/2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me kriteret e tyre, Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Sipas Nenit 10 të Ligjit Nr. 03/L-079, i cili ka ndryshuar nenin 7.1 të UNMIK/REG/2006/50, Komisioni për Kërkesa Pronësore ("Komisioni") duhet të emërohet nga Kuvendi me nominim nga Kryetari i Gjykatës Supreme, me kusht që deri në përfundim të mbikëqyrjes ndërkombëtare mbi zbatimin e Propozimit Gjithëpërfshirës të Marrëveshjes për Statusin e Kosovës të datës 26 mars 2007, dy nga tre anëtarët, përfshirë Kryetarin, duhet të emërohen nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar.

3. Më 18 qershor 2008, Komisioni i ka dërguar letër Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë duke cekur se e kupton që Neni 10 dhe

dispozitat tjera relevante të Ligjit Nr. 03/L-079 nuk i shkarkojnë anëtarët aktual të Komisionit nga mandati i tyre dhe që, rrjedhimisht, vazhdimi i emërimit të tyre nga Përfaqësuesi Special i datës 22 prill 2008 vazhdon të jetë valid, pos nëse nuk përfundohet më herët në pajtueshmëri me ligjin e aplikueshëm. Rrjedhimisht, Komisioni është këshilluar nga Zyra e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar që procedurat mbi emërimet e reja të dhëna në Nenin 10 të Ligjit Nr. 03/L-079 nuk ndikojnë në autoritetin e Komisionit që në përbërjen e tij të ushtrojë funksionin e vet. Zyra e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar ka konfirmuar se Neni 10 vetëm ofron një procedurë të re për emërimet përkitazi me emërimet e anëtarëve të Komisionit në të ardhmen.

4. Nga ajo që u tha më sipër, Komisioni konsideron se është i caktuar sipas rregullave dhe është kompetent të ushtrojë funksionin e vet sipas UNMIK/REG/2006/50 dhe Ligjit Nr. 03/L-079, si dhe urdhëresave dhe legjislacionit relevant për zbatim, përfshirë UNMIK/ADM/DIR/2007/5 dhe Aneksin I, respektivisht.

ARSYET PËR VENDIMIN

5. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i të drejtës së ndarjes, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

në rastet ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i të drejtës së ndarjes, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079.)

6. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni duhet të zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia në mënyrë të kënaqshme dhe paraqitësi i kërkesës nuk tregon të kundërtën, të japë urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë mbi të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të përshtatur në Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë të përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të përshtatur në Ligjin. Nr. 03/L-079)¹

¹ Si duket në Aneksin I ka një gabim teknik. Gjersa Aneksi I qartësisht duket se është menduar të zëvendësojë në tërësi UNMIK/ADM/DIR/2007/5, përfshirë të tri anekset e saj, Neni 26 i Aneksit I parasheh që e drejta nga Aneksi III i UNMIK/ADM/DIR/2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila i referohet Aneksit II. Megjithatë, nuk ka asnjë dispozitë të veçantë dhe as ndonjë indikacion tjetër në Ligjin Nr. 03/L-079 apo në Anekset e tij që qëllimi i këtij ndryshimi specifik ishte të fshijë Aneksin I dhe Aneksin II të UNMIK/ADM/DIR/2007/5. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron se që të tri anekset e UNMIK/ADM/DIR/2007/5 janë të përfshira në pakon legjislative dhe Komisioni në vendimet e tij do t'u referohet atyre si Nën-Anekset I, II dhe III, respektivisht.

7. Komisioni ka mbajtur seancën e tij të dhjetë me 15-19 dhjetor 2008 në Prishtinë. Totali prej 2,051 kërkesave për pronën bujqësore i ishin paraqitur Komisionit në seancën e tij të dhjetë, nga Sekretaria Ekzekutive e Agjencisë Kosovare të Pronës (“Sekretaria Ekzekutive” dhe “KPA”, respektivisht), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata tjera relevante. Nga ky numër i kërkesave, totali prej njëmbëdhjetë kërkesave është rekomanduar nga Sekretaria Ekzekutive që të refuzohen.

8. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe i ka raportuar mbi përpunimin e kërkesave si dhe çështjet ligjore dhe dëshmuere të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informacione dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesat për pronësi

9. Për të përmbushur kriteret për kërkesë valide, paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, duhet të dëshmojë se ai apo ajo e ka pasur të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar, dhe se ai apo ajo tash nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo saj pronësore si rezultat i rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

10. Kërkesat nr. 39711, 39717, 39718, 39720, 39721, 39722, 39723, 39728, 39730, 39731 dhe 51032 janë ligjërisht të dyfishta me kërkesat të cilat janë vendosur më parë nga Komisioni në favor të bartësit të së drejtës pronësore në vendimet KPCC/D/A/3/2007 të 7 nëntorit 2007, KPCC/D/A/5/2007 të 19 dhjetorit 2007 dhe KPCC/D/A/8/2008 të 22 shkurtit 2008. Me fjalë të tjera, të gjitha këto kërkesa përfshijnë nga një kërkesë pasuese nga i njëjti bartës i së drejtës pronësore për të njëjtën parcelë. Pasi që këto kërkesa janë shqyrtuar dhe janë vendosur më parë në vendimin final të Komisionit, kërkesat qëndrojnë të refuzohen sipas nenit 11.4 të UNMIK/REG/2006/50 të përshtatur në Ligjin. Nr. 03/L-079.

11. Në kërkesën nr. 07940, paraqitësi i kërkesës ka dështuar të paraqesë ndonjë dëshmi që demonstroi se ai ka humbur posedimin e pronës së kërkuar në rrethana që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Në të vërtetë paraqitësi i kërkesës pranon se humbja e posedimit të tij është bërë si pasojë e një konflikti familjar në ose rreth vitit 1992. Prandaj kjo kërkesë qëndron të refuzohet në pajtim me nenin 3.1 të UNMIK/REG/2006/50 të përshtatur në Ligjin. Nr. 03/L-079, siç ishte rasti me kërkesat e mëparshme të paraqitura nga paraqitësi i kërkesës për të cilat është konstatuar se nuk kanë qenë të ndërlidhura me konfliktin 1998 – 1999 siç ka vendosur Komisioni në vendimin KPCC/D/A/17/2008 të 30 prillit 2008.

B. Vërejtje përmbledhëse

12. Nga ajo që u tha më sipër, Komisioni konstaton se Kërkesat nr. 07940, 39711, 39717, 39718, 39720, 39721, 39722, 39723, 39728, 39730, 39731 dhe 51032 dështojnë, dhe të lëshohet urdhër siç është dhënë më sipër

13. Komisioni cek se aty ku pronat përkatëse janë të uzurpuara në mënyrë të paligjshme, vendimi dhe urdhri i mësipërm nuk u jep asnjë të drejtë palëve përgjegjëse apo uzurpuesve aktual.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parasheh që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqes ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

* Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA39711
KPA39717
KPA39718
KPA39720
KPA39721
KPA39722
KPA39723
KPA39728
KPA39730
KPA39731
KPA51032
KPA07940